



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 23, Datë 26.02.2016

PËR

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË RREGULLOREN NR. 129, DATË 26.11.2015
“PËR MARRËDHËNIET E PUNËS TË PUNONJËSVE NË AUTORITETIN E
MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të pikës 12, të nenit 14 dhe nenit 20, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren nr. 129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Neni 1

Në nenin 10, në pikën 2, shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Kontrata e punës lidhet me afat një vjeçar për punonjësit, për arsye objektive, që lidhen me ciklin një vjeçar të raportimit të të dhënave nga shoqëritë e mbikëqyrura nga AMF-ja dhe me inspektimin e mbikëqyrjen e këtyre subjekteve. Pas përfundimit të afatit një vjeçar dhe pas vlerësimit pozitiv të punës së realizuar, lidhet kontratë pune paafat.”

Neni 2

Në nenin 14, në fund, pas pikës 4, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për kualifikimet profesionale të ofruara nga AMF-ja, brenda ose jashtë vendit dhe të vlerësuara të rëndësishme për kryerjen e detyrës ose për shkak të “fee”, do të lidhet një aneks kontratë me këtë përmbajtje: “Krahas pranimin të këtij kualifikimi punonjësi ka edhe detyrimin për kthimin e “fee”, në rast dorëheqjeje para përfundimit të afatit të kontratës, ose më parë se 3 vjet nga ky kualifikim, kur punonjësi ka kontratë pa afat”. Ky Aneks i kontratës lidhet para fillimit të këtij kualifikimi profesional.”

Neni 3

Këto shtesa hyjnë në fuqi nga data 01.03.2016.